



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2020:003690

Datë: 03.07.2020

Numri i dokumentit: 01004980

P.nr.10/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit L.S nga Gjilani, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 i KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.26/20, të datës 10.01.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar 24.06.2020 dhe pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit, me datë 25.06.2020 mori dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri L.S nga babai I... dhe nëna M..., e lindur J..., i lindur me datë ....., në Gjilan, ku dhe jeton rruga "...", numër ..., i martuar, i punësuar në ndërtimtari, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 19.12.2019, rreth orës 00:10 minuta në Gjilan, në rrugën "Avdulla Presheva", pa autorizim ka poseduar, mbajtur dhe përgatitur për ta konsumuar sasinë prej 53,6 gram të substancës narkotike të llojit "Marihuanë", që ishte i presuar dhe i vendosur në një gotë qelqi, 1.1 gram që ishte i vendosur në grinder dhe 1 shpric me vaj të kanabisit në sasinë prej 9,2 gramëve bashkë me një thikë me ngjyrë të gjelbër, një pako rizlla si dhe 2 grirëse për përpunimin e marihuanës, në atë mënyrë që të gjitha këto i ka siguruar prej personave të ndryshëm në Gjilan dhe më pas nga pak atë e ka përgatit me mjetet e lartpërmendura dhe e ka konsumuar deri në momentin kur policia ka shkuar tek shtëpia e tij për tu marrë me një rast të dhunës në familje me ç'rast e kontrollon dhe në xhepin e majtë të pantallonave të tij i gjen dhe përkohësisht i sekuestron mjetet me të cilat përgatitej dhe sasinë e lartpërmendur të substancës narkotike e cila pas testit fushor të kryer ka rezultuar se është narkotik i llojit "Marihuanë".

-Me çka ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 i KPRK-ës.

andaj, në bazë të neneve 1,2,4,38,39,40,42,43,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 248 dhe 365 të KPP-ës të pandehur L.S:

## E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 400 € (katërqind euro) dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 €(njëzet euro) do të caktohet një ditë burgim.

Në bazë të nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-ës nga i pandehuri i lartcekur KONFISKOHET substanca narkotike e llojit “Marihuanë”, në peshë të përgjithshme prej 54,7 gram, 9.2 gram vaj kanabisi, 1 shpric, 2 grindera-grirëse për përpunimin e marihuanës, 1 pako rizlla dhe 1 thikë me ngjyrë të gjelbër.

Obligohet i pandehuri i lartcekur që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 30 € (tridhjetë euro), të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, në kërcënimin të përmbarrimit të dhunshëm

## A R S Y E T I M

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan- Departamenti i Përgjithshëm, me datë 23.03.2020, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.26/20, kundër të pandehurit L.S nga Gjilani, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Më datë 23.06.2020, në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit dhe i pandehuri L.S. Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës i pandehuri i lartcekur ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë, me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

## 2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë palët e lartcekura, pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprat penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 248 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht pas njoftimeve lidhur me pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë deklarata e të pandehurit L.S e dhënë në Stacionin Policor në Gjiilan ku i njejt qysh në atë stad të procedurës kishte pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, dëftesa mbi konfiskimin e pronës, formular prone/dëshmi, raporti për testin fushor, informacionet e personit, raportet e oficerëve, foto dokumentacioni si dhe shkresat e tjera të lëndës gjithashtu me rastin e pranimit të fajësisë gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

## 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri L.S ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 i KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## 4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar se të pandehurit L.S duhet ti shqiptohet me gjobë në shumë prej 400 €(katërqind euro) dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70,71 dhe 72 të KPRK-së, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit si dhe faktin se i njejt në çdo stad të procedurës penale ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihej në barrë, bashkëpunimin e përgjithshëm të të pandehurit me gjykatën për faktin se i njejt ka qenë korrekt në sjelljet e tija dhe përgjigjen e tij ndaj ftesave të gjykatës, keqardhjen e shfaqur nga ana e tij për veprimet të cilat i ka ndërmarë si dhe pendimin e tij meqenëse i njejt në çdo stad të procedurës ka shfaqur keqardhjen e tij si dhe pendimin për kryerjen e kësaj vepre penale, gjithashtu gjykata si

rrethanë lehtësuese mori edhe premtimin e të pandehurit që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla penale dhe as vepra të tjera penale ndërsa si rrethana rënduese për të pandehurin gjykata mori shkallën e lartë të dashjes ngase sipas përshkrimit faktik si dhe vet deklarimit të të pandehurit del se i njëjti për kryerjen e kësaj vepre penale ka paraqitur një shkallë të lartë të planifikimit fakt ky i cili vërtetohet edhe nga sendet e konfiskuara si në dispozitivin e këtij aktgjykimi e me të cilat i njëjti ka përgatitur një sasi të konsiderueshme të substancës narkotike të llojit “Marihuanë”, për konsumim andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 5.Vendimi lidhur me konfiskimin

Në bazë të nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-ës gjykata ka vendosur që nga i pandehuri i lartcekur të KONFISKOHET substanca narkotike e llojit “Marihuanë”, në peshë të përgjithshme prej 54,7 gram, 9.2 gram vaj kanabisi, 1 shpric, 2 grindera-grirëse për përpunimin e marihuanës, 1 pako rizlla dhe 1 thikë me ngjyrë të gjelbër.

#### 6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 50 € (pesëdhjetë euro) dhe shumë prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, në kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.10/2020, me datë 25.06.2020

Zyrtarja Ligjore,  
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermaxhaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.